




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA PROTIV KORRUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-3484/13</u>
Nr. i faq. Broj stranica <u>04</u>	Data Datum <u>23.10.2013</u>
Nr. pages	Date
PRISTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	23/10/2013
REFERENC-Ë:	AKK - DPK
PËR/ZA/TO:	Autoritetet Kontraktuese Zyrtarëve Përgjegjës
CC:	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik Safet HOXHA – Kryetar i KRPP-së
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me: “KUSHTET PËR PJESËMARRJE” në Dosjet e Tenderëve.



Të nderuar!

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me: “KUSHTET PËR PJESËMARRJE” dhe “INFORMACIONET ADMINISTRATIVE” në Dosjet e Tenderëve, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga të gjitha Autoritetet Kontraktues në Kosovë, që t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje “KUSHTET PËR PJESËMARRJE” dhe “INFORMACIONET ADMINISTRATIVE” në Dosjet e Tenderëve, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsion gjatë ushtrimit të mandatit të sajë ligjor, gjatë punës zyrtare, ka hasur në një fenomen të përgjithshëm tek shumica e Autoriteteve Kontraktuese. Autoritetet në fjalë në “Dosje e Tenderit” tek “KUSHTET PËR PJESËMARRJE”, konkretisht në “Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar” ose “Kapaciteti Teknik dhe Profesional” po kërkojnë qarkullim financiar në shuma të larta, të cilat shpeshherë tejkalojnë shifrën milionëshe. Varësisht nga Autoriteti Kontraktues, kërkojnë dëshmi bankare, ose Kontrata që dëshmojnë vlerën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues, në mënyrë që të jenë pjesë e konkurrimit.

Fenomen tjetër është se Autoritetet Kontraktuese në shumicën e rasteve i ngatërrojnë “Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar” me “Kapaciteti Teknik dhe Profesional”. Disa nga këto raste janë të poshtëshënuara. Rastet konkrete të gjeturat nga AKK gjatë dy muajve të kaluar (Shtator-Tetor/2013) duke i renditur nga vlera më e madhe, tek ajo më e vogël.

Në “Njoftim për Kontratë” me numër prokurimi: 208 13 068 511, të datës 09/10/2013, me titull: “Ndërtimi i shkollës fillore në Mitrovicë” Autoriteti Kontraktues – Ministria e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë, tek “KUSHTET PËR PJESËMARRJE”, Kërkesat mbi gjendjen Ekonomike dhe Financiare kërkohej: Qarkullimi financiar për tri vitet e fundit (2010, 2011, 2012) të jetë min. 6.000.000,00 €

Në “Njoftim për Kontratë” me numër prokurimi: 632 13 062 511, të datës 09/10/2013, me titull: Ndërtimi –Asfaltimi i rrugës në fshatin Doblibare, Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prizrenit, tek “KUSHTET PËR PJESËMARRJE”, Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar kërkohej: Qarkullimi financiar në tre vitet e fundit(2010, 2011, 2012) minimum 2.000.000,00 €

Në “Njoftim për Kontratë” me numër prokurimi: GRA-618 13 071 521, të datës 16/10/2013, me titull: “Asfaltimi i rrugëve dhe mirëmbajtja e trotuareve dhe sinjalizimi”, Autoriteti Kontraktues – Komuna e Graçanicës, tek “KUSHTET PËR PJESËMARRJE”, Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar, kërkohej: Raport mbi dëshminë e qarkullimit financiar për 3 vitet e fundit (2010, 2011, 2012, minimum 1.000.000,00 €.

Në “Njoftim për Kontratë” me numër prokurimi: 615 13 164 521, të datës 18/09/2013, me titull: “Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dumnicë e Poshtme dhe Dumnicë e Epërme”, Autoriteti Kontraktues – Komuna e Podujevës, tek “KUSHTET PËR PJESËMARRJE”, Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar, kërkohej: Qarkullimi financiar në tre vitet e fundit (2010, 2011, 2012) minimumi në vlerë prej 700.000,00 €. Kapaciteti Teknik dhe Profesional, kërkohej: Kontratat për ndërtim – asfaltimin e rrugëve, minimumi në vlerë prej 600.000,00 € për periudhën (2010, 2011,2012)

Në “Njoftim për Kontratë” me numër prokurimi: 616 13 180 521, të datës 20/09/2013, me titull: “Vazhdimi i ndërtimit të rrugës në Mat, prej proit me tre krah”, Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës, tek “KUSHTET PËR PJESËMARRJE”, Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar-për OE, kërkohej: Qarkullimi në vitet 2010, 2011, 2012 minimum 600.000,00 €; Kontrata për sanime ndërtime apo asfaltime të rrugëve të së paku një vlerë minimum 250.000,00 €, për tri vitet e fundit (2010, 2011,2012); Referenca ose raporte të pranimeve teknike për sanime, ndërtime apo asfaltime

të rrugëve së paku një vlerë minimum 250.000,00 € për tri vitet e fundit (2010, 2011,2012) , (referencat duhet të jenë për kontrata të tri vitet e fundit 2010, 2011, 2012).

Në “Njoftim për Kontratë” me numër prokurimi: 624 13 041 521, të datës 03/09/2013, me titull “Ndërtimi i rrugëve dhe Trajtimi i ujërave atmosferike në fshatin Samadraxhë – Rivitalizimi i Kroit të Madh Samadraxhë”. Autoriteti Kontraktues – Komuna e Suharekë, tek “KUSHTET PËR PJESËMARRJE”, Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar, kërkohet: Raportin ose raportet përkatëse nga një ose më shumë banka në vlerë 200.000,00 € të vërtetuara në banka për periudhat: 2010, 2011, 2012; Kapaciteti Teknik dhe Profesional, kërkohet: Kontratat për kryerjen e punëve të ngjashme, kopje për tri vitet e fundit me totalin e qarkullimit prej 400.000,00 €, referencat për tri vitet e fundit: 2010, 2011, 2012.

Në “Njoftim për Kontratë” me numër prokurimi: 622 13 310 111, të datës 10/10/2013, me titull “Furnizimi, me thëngjill për ngrohje për nevojat e Komunës së Prizrenit”- 2 loto, Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prizrenit, tek “KUSHTET PËR PJESËMARRJE” Dëshmia OE për qarkullim financiarë që në tri vitet e fundit (viti, 2010, 2011, 2012 dhe 2013) ka realizuar vlerën prej 300.000,00 € (e dëshmuar me kontrata)

Në “Njoftim për Kontratë” me numër prokurimi: 616 13 179 521, të datës 20/09/2013, me titull: “Renovimi dhe gëlqerosja e disa Shkollave”, Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës, tek “KUSHTET PËR PJESËMARRJE”, Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar, kërkohet: Qarkullimi në vitet 2010, 2011, 2012 minimum 300.000,00 €; Kontrata për ndërtime ose renovime të kryera brenda këtyre tri viteve së paku në shumën 300.000,00 €, prej tyre së paku një kontratë në vlerë min. 150.000,00 €; Referencat për punë të kryera brenda këtyre tri viteve së paku 300.000,00 €, prej tyre së paku një referencë në vlerë min. 150.000,00 € ose dy në vlerën 100.000,00 €.

Në “Njoftim për Kontratë” me numër prokurimi: 206 13 086 121, të datës 04/09/2013, me titull: “Furnizim me barna, material medicinal, material stomatologjik dhe pajisje medicinale”, Autoriteti Kontraktues – Ministria e Shëndetësisë”, tek “KUSHTET PËR PJESËMARRJE”, Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar, kërkohet: Dëshmi nga ATK për kryerjen e obligimeve tatimore, ku dëshmohet edhe qarkullimi financiar 100.000,00 € për periudhën (2010, 2011, 2012)

Në “Njoftim për Kontratë” me numër prokurimi: 19595 13 081 521, të datës 23/09/2013, me titull: “Kubëzimi dhe rregullimi i kanalit të hapur në rrugën Mulla Agani”, Autoriteti Kontraktues – Komuna e Pejës, tek “KUSHTET PËR PJESËMARRJE”, Kapaciteti Teknik dhe Profesional, kërkohet: Qarkullimi financiar për vitin 2010, 2011, 2012 minimum 100.000,00 €; Kontratat për këtë veprimtari brenda këtyre viteve së paku prej: 50.000,00 € për periudhën (2010,2011,2012); Referencat për punë të njëjta në vlerë prej 50.000,00 € për periudhën (2010,2011,2012)

Në “Njoftim për Kontratë” me numër prokurimi: 47019 13 080 521, të datës 23/09/2013, me titull: “Ndërtimi i kanalit të ujitjes në fsh. Pishtanë-Kërstove (lot.1), Ndërtimi i kanalit të ujitjes në fsh. Baran(lot.2), Ndërtimi i digës në fsh. Ozdrim (lot.3) Ndërtimi i digës në fsh. Doberdo (lot.4), dhe ndërtimi i digës në fsh. Treboviq (lot.5)”, Autoriteti Kontraktues – Komuna e Pejës, tek “KUSHTET PËR PJESËMARRJE”, Kapaciteti Teknik dhe Profesional, kërkohet: Qarkullimi financiar për vitin

2010, 2011, 2012 minimum 100.000,00 €; Kontratat për këtë veprimtari brenda këtyre viteve së paku prej: 50.000,00 € për periudhën (2010,2011,2012); Referencat për punë të njëjta në vlerë prej 50.000,00 € për periudhën (2010,2011,2012)

Në “Njoftim për Kontratë” me numër prokurimi: 622 13 306 121, të datës 10/10/2013, me titull “Furnizim me inventar për nevojat e shkollave të Komunës së Prizrenit”, Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prizrenit, tek “KUSHTET PËR PJESËMARRJE” kërkohet: Dëshmia OE për qarkullim financiarë që në tri vitet e fundit (viti, 2010, 2011, 2012 dhe 2013) ka realizuar vlerën prej 50.000,00 € (e dëshmuar me kontrata)

Autoritetet Kontraktuese me kriterin e shumës së qarkullimit financiar bëjnë që disa nga Operatorët Ekonomik të mos jenë në gjendje të konkurrojnë dhe të jenë pjesë e konkurrencës së lirë dhe të ndershme. Kriteret e tilla diskriminojnë disa Operator Ekonomik, dhe në të njëjtën kohe favorizojnë tjerët.

Fenomen tjetër është se disa nga Autoritetet Kontraktuese kërkojnë pagesë për dosjen e tenderit, në rastet e më poshtme konsiderojmë se është e panevojshme të kërkohet shuma e caktuar.

Në “Njoftim për Kontratë” me numër prokurimi: Vi657 13 058 121, të datës 07/10/2013, me titull “Furnizimi me artikuj ushqimor për të gjitha njësitë shpenzuese”, Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vitisë, tek “INFORMACIONET ADMINISTRATIVE” kërkohet që Operatorët Ekonomik, të paguajnë shumën prej 25 €, ndërsa nuk jepet asnjë detaj tek Kushtet dhe metoda e pagesës..

Në “Njoftim për Kontratë” me numër prokurimi: 622 13 271 121, të datës 18/09/2013, me titull “Furnizimi me material ushqimor dhe higjenik për familjet e dëshmorëve të Komunës së Prizrenit”, Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prizrenit, tek “INFORMACIONET ADMINISTRATIVE” kërkohet që Operatorët Ekonomik, të paguajnë shumën prej 20 €, ndërsa Kushtet dhe metoda e pagesës shkruan: duhet të merren fatura në zyrën e prokurimit nr. __ (Nuk ka numër të zyrës)

Në “Njoftim për Kontratë” me numër prokurimi: 655 13 035 121, të datës 03/09/2013, me titull “Blerja e mekanizmit bujqësor moto kultivator”, Autoriteti Kontraktues – Komuna e Shtërpcës, tek “INFORMACIONET ADMINISTRATIVE” kërkohet që Operatorët Ekonomik, të paguajnë Çmimi: 10 € .

Të gjeturat më lart bien ndesh me nenin 27, Dosja e Tenderit; Neni 48, Dorëzimi i Dosjes së Tenderit; Neni 68 Gjendja Ekonomike Financiare; dhe Nenin 69, Aftësia teknike dhe/ose Profesionale.

AKK rekomandon tek të gjitha Autoritetet Kontraktuese ti marrin masat e duhura që në të ardhmen të shmangen praktika të tilla, ndërsa për rastet e gjetura do të procedohet në pajtim me ligjet në fuqi.

Me respekt!